

VENDIM
Nr. 517, datë 25.9.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRISË SË DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Drejtësisë është organi përgjegjës për zbatimin e politikës së drejtësisë, në kërkim të respektimit të Kushtetutës, të ligjeve, realizimit dhe mbrojtjes së dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, dhe kontribuon në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje e në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik e të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, nëpërmjet plotësimit të kuadrit ligjor e institucional, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë dhe të legjislacionit në fuqi.

3. Fushat e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë dhe kompetencat për realizimin e tyre parashikohen në nenet 5 dhe 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar.

4. Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ushtron çdo përgjegjësi tjetër shtetërore që i ngarkohet me ligj ose akte të Këshillit të Ministrave.

5. Vendimi nr. 606, datë 20.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama